

Mirësevini në Mbretërinë e Bashkuar



Ligjet dhe jeta në Mbretërinë e Bashkuar



Në Mbretërinë e Bashkuar Policia ekziston për të mbrojtur njerëzit, të drejtat e tyre dhe ligjin. Respektimi i ligjit është shumë i rëndësishëm në Mbretërinë e Bashkuar dhe të gjithë duhet t'i binden ligjit. Nëse e shkelni ligjin, ekzistojnë pasoja. Ju mund të merrni një gjobë ose mund të shkoni në burg. Mund të ndikojë gjithashtu në një aplikim të ardhshëm për shtetësi në MB.

Policia ka për detyrë të mbështesë ligjin në mënyrë të vendosur, të parandalojë krimin, të sjellë para drejtësisë ata që shkelin ligjin, të mbajë paqen dhe të mbrojnë, ndihmojnë dhe sigurojnë komunitetin. Ata janë atje për t'ju ndihmuar dhe mbështetur, dhe ju nuk duhet të keni frikë t'i afroheni atyre nëse jeni viktimë e një krimi, shihni një krim që ndodh, ose për ndihmë të përgjithshme për shembull nëse keni të humbur.

Është e rëndësishme të dini se, disa gjëra që mund të lejohen në vendet e tjera, nuk janë të pranueshme në Mbretërinë e Bashkuar dhe është përgjegjësia juaj të respektoni ligjin në Mbretërinë e Bashkuar. Gjithashtu është e rëndësishme të kuptohet se disa gjëra, që mund të mos lejohen në vendet e tjera, por mund të jenë të ligjshme në Mbretërinë e Bashkuar.

Qëndrimi në shtëpi në Mbretërinë e Bashkuar

Për të qenë një fqinj i mirë duhet të përpiqeni gjithmonë ta mbani zhurmën në minimum, natën vonë dhe herët në mëngjes, dhe të informoni fqinjët nëse, planifikoni të bëni një festë ose të keni një numër të madh të mysafirëve që do t'ju vizitojnë. Është e rëndësishme të mbani të mbyllura dyert dhe dritaret tuaja, gjatë gjithë kohës dhe të ruani sende si biçikleta dhe pajisje elektronike në një vend të sigurt. Nëse dëshironi të shikoni televizor në shtëpinë tuaj, ligji thotë që ju duhet të paguani për të marrë një Licencë për Televizorin.



Ju duhet të mësoni se cilën ditë duhet të nxirni jashtë koshin tuaj, për mbledhjen e mbeturinave. Më pas duhet të merrni koshin brenda, pasi të jetë zbratur. Në shumicën e zonave ka kosha të ndryshëm, kuti ose çanta grumbullimi, për lloje të ndryshme mbeturinash (për shembull, materialet e riciklueshme).

Në Mbretërinë e Bashkuar, të gjithë kanë përgjegjësi për t'u kujdesur për mjedisin e tyre lokal. Kjo do të thotë që ju nuk duhet të lini mbeturina në hapësira publike ose në rrugë, por gjithmonë përdorni koshat e mbeturinave dhe të riciklimit. Hedhja / lënia / vendosja e mbeturinave jashtë koshave, konsiderohet vepër penale, që përfshin çamçakëz, cigare dhe fara. Këto quhen mbeturina dhe mund të gjobiten. Gjithashtu nuk është e pranueshme të pështyni në rrugë ose në vende të tjera publike dhe mund të rezultojë në gjobitje.

Në Mbretërinë e Bashkuar është e paligjshme ti japësh biçikletës në trotuare dhe mund të gjobitesh për këtë. Për sigurinë tuaj dhe të tjerëve, është e rëndësishme që gjatë dhënies së biçikletës natën, të keni drita në biçikletën tuaj, si përpara ashtu edhe mbrapa.

Drejtimi i automjetit në Mbretërinë e Bashkuar



Agjencia e Patentave për Drejtimin e Automjetit e referuar si DVLA, nuk lejohet t'ju japë një leje drejtimi nëse nuk jeni "rezident i ligjshëm" në Mbretërinë e Bashkuar. Kjo vlen për të gjithë njerëzit që nuk kanë leje për të qëndruar. DVLA mund të revokojë (anulojë) patentën tuaj të shoferit nëse mendojnë se nuk jeni në Mbretërinë e Bashkuar me leje. DVLA nuk ka pse t'ju njoftojë nëse do të anulohet patentën tuaj. Kjo do të thotë që ju mund të mos e dini, se jeni duke i dhënë makinës në mënyrë të paligjshme, derisa të ndaloheni nga policia.

Nëse keni një patentë të plotë të vlefshme, të lëshuar në vendin tuaj të lindjes, ju mund të jeni në gjendje të drejtoni makinën në këtë vend, deri në 12 muaj nga data që keni mbërritur në vend, megjithatë duhet të kontrolloni më parë me DVLA. Pas 12 muajsh duhet të merrni një Patentë Shoferi Britanike. Ekziston mundësia që do t'ju duhet të bëni mësim shoferi, përpara se të jeni në gjendje të kaloni provën dhe të merrni një Patentë Shoferi Britanik. Ju duhet të jeni në moshën 17 vjeç, për të drejtuar makinën në Mbretërinë e Bashkuar.

Të kesh një patentë shoferi të vlefshme është vetëm një nga gjërat që kërkohen, përpara se të mund të drejtosh një makinë në Mbretërinë e Bashkuar, do t'ju duhet gjithashtu

- Një certifikatë sigurimi që ju mbulon për të drejtuar makinën
- Makina duhet të ketë taksën e rrugës
- Makina duhet të ketë kaluar kontrollin teknik vjetor, i cili njihet si MOT

Ju do të duhet të jeni shumë të kujdesshëm kur drejtoni një makinë, nëse ajo ju është huazuar nga një mik, pasi është shkelje të drejtosh një automjet pa licencë të vlefshme, certifikatë sigurimi, taksë rrugore dhe certifikatë MOT. Policia ka kompetenca të ndalojë shoferët për çdo lloj arsye. Kjo do të thotë se ata kanë të drejtë t'ju ndalojnë edhe nëse nuk mendojnë se keni bërë diçka të gabuar. Nëse ndaloheni nga policia kur drejtoni makinën, ajo mund të kërkojë të shikojë patentën tuaj të drejtimit, sigurimin dhe certifikatën MOT. Nëse nuk i keni me vete këto dokumente, duhet t'i çoni në një stacion policie brenda 7 ditësh. Nëse nuk i çoni në një stacion policie brenda 7 ditësh, atëherë ju jeni duke shkelur ligjin dhe mund të dërgoheni në gjykatë. Nëse një oficer policie mendon se nuk keni certifikatën e sigurimit, ai mund t'ju merr makinën derisa të provoni se jeni siguruar.

Nëse vendosni të drejtoni një makinë, duhet të jeni të vetëdijshëm se është shkelje:

- Të ecni mbi kufijtë e shpejtësisë të vendosur për rrugë të ndryshme. Në Mbretërinë e Bashkuar kufijtë e shpejtësisë janë në milje në orë dhe jo kilometra.
- Të drejtoni një automjet në rrugë apo vend publik nëse jeni nën ndikimin e pijeve alkoolike ose drogës.
- Të përdorni telefonin kur jeni duke i dhënë makinës.
- Të pini duhan në makinën tuaj, nëse ndodhet një fëmijë me ju, brenda në makinë.
- Cdo pasagjer duhet të ketë sediljen e tij dhe të vendosë rripin e sigurimit.
- Shoferi është përgjegjës që të gjithë fëmijët nën 14 vjeç të vendosin rripin e sigurimit dhe të kenë ndenjësën për fëmijët.

Puna në Mbretërinë e Bashkuar

Azilkërkuarit nuk lejohen të punojnë në Mbretërinë e Bashkuar derisa t'ju aprovet leja e qëndrimit. Nëse prisni më shumë se 12 muaj për një vendim fillestar të kërkesës suaj, mund të kërkonte leje për të punuar. Nëse ju jepet leja për të punuar, nuk do t'ju lejohet të vetëpunësoheni dhe do t'ju lejohet të merrni vetëm një punë e cila është e përfshirë në listën e profesioneve për të cilat ka nevojë, të botuara nga Zyra e Vizave dhe Emigracionit në Mbretërinë e Bashkuar. Nëse punoni gjatë kohës që nuk ju është dhënë e drejta për punë, mund të ju konfiskohen fitimet ose pronat nga qeveria. Ekziston gjithashtu një rrezik që të ndiqeni penalisht ose të deportoheni.



Kini kujdes se, nëse dikush ju afrohet me oferta për punë, ata mund ta dinë që ju nuk keni të drejtë të punoni dhe ata mund t'ju shfrytëzojnë për përfitime kriminale, ata mund të përpiqen t'ju detyrojnë të punoni duke përdorur kërcënime, forcë, mashtrim, ose abuzim me pushtetin. Për shembull, ata mund: Të gjejnë informacione personale për ju, dhe më pas, të përdorin kërcënime ndaj familjes tuaj në mënyrë që t'ju manipulojnë dhe t'ju kontrollojnë, ose të përdorin frikën bazuar në statusin tuaj të imigracionit, duke tentuar t'ju kontrollojnë. Në Mbretërinë e Bashkuar kjo njihet si Skllavëria Moderne dhe nëse mendoni që ju ose dikush që njihni, po shfrytëzohet në këtë mënyrë duhet të kontaktoni policinë. Meqenëse kërkesa juaj për azil, mund të marrë shumë kohë për tu zgjidhur, edhe pse nuk mund të punoni, përsëri mund të përdorni kohën tuaj të lirë, duke u bërë pjesë e komunitetit tuaj lokal, të bashkoheni në aktivitete, të takoni njerëz dhe të shfrytëzoni mundësi për të punuar vullnetarisht.



Ligjet në lidhje me seksin në Mbretërinë e Bashkuar

Në Mbretërinë e Bashkuar, konsiderohet shkelje, të kryesh marrëdhënie seksuale në çdo, kohë pa pëlqimin e personit tjetër (kjo do të thotë, që të dy njerëzit, bien dakord me dëshirë, për atë që po ndodh, dhe kanë lirinë dhe aftësinë për ta bërë atë zgjedhje). Kjo përfshin një kontakt fizik të padëshiruar si prekja në çfarëdo mënyre, puthja ose mbajtja e dikujt. Kjo përfshin gruan, të dashurën ose partnerin tuaj.

Është e rëndësishme të mbani mend se, nëse dikush është shumë i dehur ose nën efektin e substancave narkotike, ata nuk mund të japin pëlqimin. Nëse tentoni të kryeni marrëdhënie seksuale, në ndonjë mënyrë, me dikë që është i dehur ose nën efektin e substancave narkotike, personi nuk e di se çfarë po ndodh, dhe për këtë arsye nuk mund të japë pëlqimin e tij, është e barabartë me përdhunimin e tij.

Është shkelje të kesh imazhe pornografike të fëmijëve nën moshën 18 vjeç, përfshirë dhe telefonin tënd celular. Nëse merrni një foto pornografike të një fëmije nën moshën 18 vjeç, mos ia përcillni askujt, fshini foton dhe ndërprini kontaktin me personin që ta ka dërguar. Nëse mendoni se dikush po abuzohet, duhet ta raportoni në Polici.

Është shkelje për një mashkull apo femër që të kryejnë marrëdhënie seksuale me çdo person, i cili është nën moshën 16 vjeç edhe nëse ata pranojnë. Është e rëndësishme të mos supozoni se një person është mbi 16 vjeç, sepse po i takoni diku në një pub ose një klub. Në Mbretërinë e Bashkuar nuk është e pranueshme të krijohen marrëdhënie romantike me njerëz nën 16 vjeç.

Nëse jeni të vetëdijshëm se jeni HIV pozitiv, është e rëndësishme që t'i tregoni partnerit tuaj para se të kryeni një marrëdhënie seksuale, nëse nuk e bëni këtë, kjo mund të çojë deri në procedim penal. Të qenit HIV pozitiv nuk do të ndikojë në kërkesën tuaj për azil ose nuk do të çojë në dëbimin tuaj nga Mbretëria e Bashkuar.

Ju mund të jetoni në zona ku punëtorët e seksit ose njerëzit në prostitucion, gjenden duke ecur në rrugë, megjithatë është e rëndësishme të dini se, në këtë vend është e paligjshme ti afrosh dikujt në publik dhe t'i kërkosh seks. Ju këshillojmë që të mos hyni në biseda me njerëz në prostitucion, pasi ekzistojnë një varg qëndrimesh dhe prirjesh kulturore, të cilat mund të çojnë në keqkuptime dhe mund t'ju rrezikojnë.



Alkoli, Duhani dhe Droga

Mosha ligjore për të blerë alkool është 18 vjeç. Është shkelje për një të rritur që të blejë ndonjë pije alkoolike për cilindo nën moshën 18 vjeç. Disa vende publike janë caktuar 'Zonë e Lirë pa Alkool'. Nëse kapeni duke pirë në një nga këto zona, mund të gjobiteni. Ekzistojnë gjithashtu kufizime për të rinjtë nën moshën 16 vjeç që blejnë pije energjike që përmbajnë doza të larta kafeine.

Mosha ligjore për të blerë cigare ose duhan është 18 vjeç. Është shkelje për një të rritur që të blejë cigare për këdo nën moshën 18 vjeç. Është e paligjshme pirja e duhanit në të gjitha zonat publike të mbyllura ose të mbyllura në mënyrë të konsiderueshme dhe vendet e punës. Kjo përfshin pirjen e duhanit në automjete të cilat i shërbejnë publikut siç janë autobusët dhe trenat. Nuk ka asnjë kufizim ligjor për cigaret elektronike në Mbretërinë e Bashkuar, megjithatë cigaret elektronike janë të ndaluar në vendet e punës, jashtë spitaleve dhe pranë ndërtesave publike.

Nëse kapeni duke përdorur, poseduar ose shitur droga të paligjshme, mund të arrestoheni. Ju mund të mbani barna që blijnë nga një farmacist ose ilaçe që ju janë përshkruar nga mjeku juaj. Droga ilegale klasifikohet A B dhe C, me droga të Klasës A të trajtuara nga ligji si më të rrezikshmet. Kanabisi i cili edhe pse është dekriminalizuar në disa vende është një drogë e Klasës B në Mbretërinë e Bashkuar dhe është i paligjshëm të përdoret edhe në shtëpinë tuaj. Vlen gjithashtu të përmendet se khat, një bimë që përdoret si stimulues në disa komunitete Somaleze është e paligjshme dhe është një ilaç i klasit C në Mbretërinë e Bashkuar.



Vlerat, përgjegjësitë, të drejtat dhe liritë në Mbretërinë e Bashkuar.

Britania e Madhe vlerëson ndryshimet kulturore dhe fetare, dhe toleranca dhe drejtësia janë vlera të rëndësishme. Nuk tolerohen pikëpamjet fetare, ekstremiste ose raciste të krahut të djathtë. Njerëzit duhet të respektojnë pikëpamjet, fenë dhe veshjen e njëri-tjetrit, edhe nëse është e ndryshme nga ajo që janë mësuar.

Ju jeni të lirë të praktikoni fenë tuaj në Mbretërinë e Bashkuar. Ju mund të gjeni kisha, xhami, sinagoga ose vende të tjera adhurimi në fshatra dhe qytete.

Në Mbretërinë e Bashkuar është e paligjshme të trajtosh njerëzit në mënyrë të keqe ose të ndryshme, për shkak të origjinës, gjinisë, seksualitetit, fesë, pikëpamjeve politike, moshës ose aftësisë së kufizuar dhe kjo njihet si një krim i urrejtjes. Një krim i urrejtjes mund të përfshijë: fyerjen, bulizmin, ofendimin, grabitjen dhe dëmtimin e shtëpisë ose makinës, mbishkrimet ose shkrimet dhe ngacmimet.

Nëse keni pësuar një krim të urrejtjes, mund ta raportoni atë në polici drejtpërdrejt, duke telefonuar në numrin e telefonit 101 dhe ata do të hetojnë dhe do t'ju ofrojnë mbështetje dhe këshilla. Kur raportoni një incident të krimit të urrejtjes, ju nuk duhet të jepni emrin tuaj. Raportimi juaj do të jetë plotësisht konfidencial. Policia e njeh ndikimin, që krimet e urrejtjes mund të kenë mbi individët dhe komunitetet dhe i merr ato shumë seriozisht. Nëse dikush është agresiv ndaj jush, opsioni i parë duhet të jetë të largoheni nga vendngjarja, të ecni ose të vraponi, të mbylleni në shtëpinë tuaj, të hyni në një dyqan dhe të kërkonti ndihmë. Pastaj telefononi Policinë. Së fundmi ju keni të drejtë të mbroheni, nëse është e nevojshme për t'ju ndihmuar të largoheni nga situata. Sidoqoftë është e rëndësishme të dini se në Mbretërinë e Bashkuar nuk mund të mbani armë për vetë mbrojtje.

Ju mund të merrni mbështetje emocionale dhe praktike nga Ndihma për Viktimat, nëse jeni viktimë e krimit. Ky shërbim ofron ndihmë nëse një viktimë e krimit ka raportuar ose jo krimin në polici. Ato gjithashtu mund t'ju ndihmojnë të raportoni një krim, përfshirë krimin e urrejtjes. Ju lutemi vizitoni faqen e internetit www.victimsupport.org.uk për të kërkuar ekipin tuaj lokal për mbështetjen e viktimave ose telefono falas në 08081689111.

Te ndaluarit dhe kerkimi

Policia mund t'ju ndalojë dhe t'ju marrë në pyetje në çdo kohë, megjithëse nuk është e zakonshme dhe nuk duhet të ndodhë rregullisht. Një oficer policie mund t'ju ndalojë dhe t'ju pyesë: Si e keni emrin, çfarë po bëni në zonë dhe ku po shkoni.

Oficerët e policisë mund t'ju kontrollojnë në varësi të situatës, duke ju kontrolluar, nuk do të thotë që po arrestoheni. Oficerët e policisë duhet të kenë arsye të forta "për të dyshuar" se po mbani: Droga të paligjshme, një armë, sende të vjedhura, diçka që mund të përdoret për të kryer një krim, siç është shufra e hekurit.

Arsye të forta mund të konsiderohen gjëra të tilla si, një oficer policie sheh diçka që del nga çanta ose xhapi juaj, ose jeni me dikë që ata e dinë se i kishte këto gjëra në të kaluarën.

Një Oficer për Mbështetjen e Policisë në Komunitet (PCSO) duhet të jetë në uniformë kur mund t'ju ndalojë. Ju lutemi kini parasysh që nganjëherë oficerët e policisë drejtojnë makina pa shenja dhe një oficer policie nuk duhet të jetë gjithmonë në uniformë, por nëse nuk janë të veshur me uniformë, ata duhet t'ju tregojnë kartën e shërbimit.

Procesi Ndalo dhe Kontrolllo nuk është vullnetar - ligji i jep policisë autoritetin për të ndaluar dhe kontrolluar, dhe nëse refuzon mund të kërkohesh me forcë.

Kontaktimi i Policisë

Ju mund të kontaktoni personalisht Policinë duke shkuar në ndonjë Stacion policor ose në telefon 24 orë në ditë.

101 është numri për të kontaktuar Policinë në situata më pak urgjente, për shembull nëse prona juaj është dëmtuar, për të dhënë informacion në lidhje me një krim, ose ndonjë pyetje të përgjithshme.

Ju gjithashtu mund të raportoni krime jo emergjente në polici në internet, duke përdorur një formular të thjeshtë raportimi. Ju do të duhet të kërkontë në internet për formën e raportimit të krimit.

999 është numri për të telefonuar nëse keni një urgjencë, për shembull nëse jeni viktimë e një sulmi ose shihni një krim që po ndodh. Kur telefononi, thoni se keni nevojë për 'Policinë', pasi i njëjti numër përdoret për të thirrur një ambulancë ose nëse ka zjarr. Të telefononi në numrin 999 është falas.

Kur telefononi në numrin 999, nëse keni nevojë për një përkthyes, ju lutemi mos e mbyllni telefonin. Tregoni se çfarë gjuhe flisni. Linja mund të mbetet e qetë (deri në 10 minuta), atëherë dikush që flet gjuhën tuaj do të vijë në linjë për t'ju ndihmuar. Nëse është një rast urgjence dhe nuk mund të prisni në telefon, thoni emrin e rrugës dhe Policia do të vijë në vend ngjarje.

Do t'ju ndihmonte shumë, nëse do të mësoni të komunikoni në Anglisht:

- Si të pyesni për Policinë
- Si të thoni adresën tuaj
- Nëse nuk jeni në adresën tuaj, të përdorni objekte rrethore për të treguar ku jeni psh: një dyqan ose emrin e rrugës.
- Të thoni se në çfarë gjuhe flisni

Në Mbretërinë e Bashkuar, Policia nuk është mbi ligjin, ju mund të bëni një ankesë kundër tyre. Ju mund të bëni një ankesë kundër një oficeri policie ose një anëtar të stafit të policisë nëse nuk jeni të kënaqur me veprimet e tyre. Ju mund ta bëni këtë duke vizituar çdo stacion policie personalisht, duke telefonuar në numrin 101 ose në faqen e internetit të forcës policore lokale

